


Kooperativat bujqësore si mundësi për rritjen e efektivitetit të parasë publike dhe zhvillimit të bujqësisë në Kosovë



Financimi i bujqësisë në Kosovë është rritur ndjeshëm ndër vite, me buxhetin për subvencione dhe transfere që ka shënuar **rritje prej 56.3%** në dhjetë vitet e fundit, nga 47.4 milionë euro në vitin 2016, në 74.1 milionë euro në vitin 2025.

Figura 1. Buxheti i Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për subvencione dhe transfere në 10 vitet e fundit (millionë euro)



Kultivimi i grurit dhe i misrit

Rritja e investimeve në bujqësi nuk është shoqëruar me një rritje të qëndrueshme të prodhimit apo kthimit të investimit nga paraja publike.

Nga 420,688 ha tokë bujqësore të shfrytëzueshme, 124,477 ha prej tyre janë të kultivuara me drithëra, ku **dominon gruri me 64.2% ose 79,970 ha**. Megjithë rritjen e pagesave direkte për grurin me 930% gjatë viteve 2010–2022, sipërfaqja e mbjellur është rritur vetëm me 2%. Një situatë e ngjashme vërehet edhe te **misri**.

Figura 2. Sipërfaqja dhe pagesat direkte për grurë gjatë viteve 2010-2022






Figura 3. Sipërfaqja dhe pagesat direkte për misër gjatë viteve 2012-2022



Një formë mbështetjeje nga Qeveria e Kosovës për bujqësinë janë edhe grantet. Ato janë rritur nga 1.2 milionë euro në 2014 në mbi 4.4 milionë euro në 2022. Megjithëse prodhimtaria e pemëve drufrutore ka shënuar rritje vitet e fundit, përkundër rritjes së granteve, ka pasur ulje të prodhimtarisë në disa vite. Ndërkohë që grantet janë katërfishuar, sipërfaqja e kultivuar vetëm është dyfishuar, çka tregon se rritja e fondeve nuk po përkthehet në zgjerim të ndjeshëm apo prodhim të qëndrueshëm.

Figura 4. Indikatorët e performancës së granteve për sektorin e pemëve druftore 2014-2022



Subvencionet dhe grantet për fermerë nuk kanë ndikuar në ndryshimin e strukturës së parcelave, si dhe prodhimi i ulët nga fermerët shkakton varësi nga importi.

Fermat përballen me sfida për shkak të madhësisë së vogël dhe mungesës së mbështetjes, duke vështirësuar mbijetesën në treg.

Cilat janë format tjera të financimit në bujqësi?

Një formë alternative apo plotësuese e financimit në bujqësi janë edhe kooperativat bujqësore. Kooperativat njihen në mbarë botën si formë e bashkëpunimit për të kapërcyer kufizimet me të cilat përballen fermerët e vegjël. Ato ofrojnë avantazhe të qarta në aspektin e qasjes më të lehtë në tregje, burime dhe mbështetje të përbashkët.

Aktualisht nuk ka ndonjë linjë buxhetore apo program të veçantë për financimin e kooperativave kosovare. Në aplikimet për grante apo subvencione përfshihen vetëm fermerët individualë ku nga kriteret e aplikimit shumë fermerë të vegjël mbesin të përjashtuar.



Ndikimi ekonomik i kooperativave

Kooperativat sigurojnë bashkëpunim afatgjatë dhe shpërndarje më të drejtë të përfitimeve, duke rritur qëndrueshmërinë e granteve investive dhe duke i dhënë Qeverisë garanci më të madhe për kthimin në investim.

Ato krijojnë tregje të reja dhe sigurojnë qasje në tregje të cilat fermerët individual nuk mund t'i arrijnë, menaxhojnë rreziqet, rrisin efikasitetin e tregut, mundësojnë negocimin e çmimeve, si dhe reduktojnë kostot e transaksioneve duke standardizuar kontratat dhe organizuar kontrollin e cilësisë.

Çka ofron kooperativa për anëtarët e saj?

Tek prodhimi:

Përmes kooperativës, anëtarët mund të blejnë pajisje, plehra, fara dhe lëndë të tjera të nevojshme në sasi të mëdha, duke përfituar nga çmimet me shumicë dhe uljet përkatëse. Gjithashtu, kooperativat mundësojnë blerjen dhe përdorimin e përbashkët të makinerive dhe pajisjeve të shtrenjta, të cilat shpesh janë të papërballueshme për fermerët individual.

Tek shitja:

Duke bashkuar prodhimin e tyre, anëtarët e kooperativës fitojnë qasje në tregje më të mëdha dhe më të leverdishme, duke negociuar çmime më të mira për produktet e tyre. Për më tepër, organizimi i transportit të përbashkët ul ndjeshëm kostot për secilin anëtar, duke krijuar përfitime nga ekonomia e shkallës në të gjitha fazat: nga blerja e lëndëve të para dhe fuqisë punëtore, te prodhimi, shpërndarja dhe investimet.

Në Kosovë, kooperativat bujqësore janë të rregulluara me Ligjin Nr. 2003/9 që nga viti 2003. Ky ligj nuk ka pësuar ndryshime përbajtësore, përveç plotësimeve në vitin 2008 (Ligji nr. 03/L-004) dhe në vitin 2022 (Ligji nr. 08/L-095).

Qeveria është duke hartuar një ligj të ri për kooperativat bujqësore, i cili edhe pse ishte në agjendën legislative të vitit 2024, pritet të dërgohet në Kuvend vetëm në nëntor 2025. Ky projektligj bazohet në koncept-dokumentin për Kooperativat Bujqësore, miratuar në gusht 2024 me vendim të Qeverisë (12/218). Krahas përfitimeve ekonomike, ligji i ri synon edhe ndikim pozitiv shoqëror dhe mjedisor. Disa nga ndikimet në ekonomi të listuara nga koncept-dokumentin më lartë janë:

- Rritja e numrit aktual të vendeve të punës;
- NDIKIMI NË QASJEN NË FINANCA PËR BIZNES;
- Ndryshimi në flukset aktuale të importit dhe të eksportit;
- Rritja e investimeve nga diaspora dhe investimeve të huaja direkte;
- Rritja e numrit të mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët;
- NDIKIMI NË RRIJEN E ARDHSHME EKONOMIKE; dhe të tjera.



Në Kosovë kooperativat përbëjnë vetëm 0.06% të gjithë ndërmarrjeve aktive. Kjo si pasojë e faktorëve të ndryshëm përfshirë mungesën e besimit në kapitalin shoqëror, mungesën e mbështetjes dhe nxitjes qeveritare kundrejt ndërmarrjeve të tilla, si dhe ndërlidhja e ideologjisë së kooperativave bujqësore me një sistem ekonomik të centralizuar.


Ndonëse fermerët e vegjël kërkojnë metoda të bashkëpunimit me fermerë të tjerë si në bashkim të burimeve por edhe strukturim të shitjes, ndërhyrjet e mëparshme të shtetit si në kooperativa ashtu edhe në sektorë të tjerë ekonomikë kanë ndikuar në besimin e fermerëve dhe vazhdojnë të pengojnë gadishmérinë e tyre për t'u bashkuar në kooperativë.

Shumë fermerë në Kosovë nuk arrijnë të bëjnë dallimin mes shoqërive tregtare të krijuara për bashkëpunim bujqësor dhe kooperativave bujqësore në pronësi të shtetit siç ishin para viteve të 90-ta. Prandaj, fermerët Kosovar aktualisht kanë tendencë t'i shmangen çdo strukture që i ngjan strukturës së organizimit gjatë kohës së ish-Federatës Jugosllave ku kooperativat më shumë se te bashkëpunimi vullnetar, bazoheshin tek bashkimi i detyruar i burimeve.

Tek problemet sektoriale të identikuara nga takimet e Sekretariatit të Këshillit Kombëtar të Kosovës për Ekonominë dhe Investimet në biznese, bizneset nga sektori i bujqësisë kanë identifikuar fuqizimin e kooperativave bujqësore si një nga nevojat më kritike.

Vendet në zhvillim kanë ndërmarrë hapa për të adresuar problemet me të cilat përballen fermerët e vegjël duke formuar kooperativa për të përmirësuar performancën e prodhimit dhe për të adresuar sfidat e reja. Në nivel të BE-së, aktualisht ka 250,000 kooperativa në pronësi të 163 milionë njerëzve, duke punësuar 5.4 milionë njerëz.

Figura 5. Vendet me pjesëmarrjen më të madhe të kooperativave bujqësore në nivel evropian



Burimi: Komisioni Evropian

Në Finlandë, prodhuesit dhe kooperativat e tyre janë në qendër të prodhimtarisë. Këto kooperativa kanë një pjesë dominuese të tregut, duke kontrolluar rreth 97% të tregut të qumështit dhe 80% të tregut të mishit. Ato kontribuojnë ndjeshëm në BPV-në e Finlandës, me gjithsej qarkullim të përbashkët prej më shumë se 35 miliardë euro në vit. Rregullimi i kooperativave bujqësore në Finlandë ndjek parimet tradicionale të kooperativave, duke siguruar trajtim të barabartë të anëtarëve, të drejta të barabarta votimi dhe kapital të pandarë. Ka mbi 3,000 kooperativa në Finlandë, me kooperativat që kanë rreth 7 milionë anëtarësi në një vend me një popullsi prej 5.5 milionë. Kjo tregon se rreth 80% e finlandezëve janë anëtarë të të paktën një kooperative, duke treguar adoptimin dhe stabilitetin e gjerë të modelit të kooperativave.

Rekomandimet e Institutit GAP për fuqizimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë:

● MBPZhR të rishikoj modelin aktual të financimit të sektorit bujqësor, duke:

- Përfshirë kooperativat si përfitues të drejtpërdrejtë, në mënyrë që edhe fermerët e vegjël të organizuar të mund të kenë qasje në mbështetje financiare, edhe nëse individualisht nuk përbushin kriteret aktuale të financimit.
- Vlerësuar rregullisht efektivitetin e pagesave direkte dhe projekteve zhvillimore si shpenzim i parasë publike në këtë sektor, përmes indikatorëve të qartë lidhur me produktivitetin e kulturave dhe projekteve të përkrahura;
- Rritur përkrahjen teknike ndaj bujqëve përmes investimit në avancimin e praktikave në bujqësi, sikurse integrimi i programe të inteligjencës artificiale si dhe duke përfituar nga praktikat e ngjashme në zbatim në shtetet e tjera, në mënyrë që të rritet produktiviteti i gjithmbarshëm;

● Ligji i ri për kooperativat bujqësore, të sigurojë një kornizë të qartë mbështetëse për krijimin dhe funksionimin e kooperativave, si dhe krijimin e një organi mbikëqyrës që do të sigurojë zbatimin e ligjit dhe funksionimin e duhur të kooperativave.

